



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE ✓

№ 2430 Prot

Vlorë, më 02.02 2025

Lënda : Mbi miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2025.

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 18, "Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil", Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil" dhe VKB nr. 102 datë 18.12.2024 "Për krijimin e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Ndërmarrjes së Gjelbërimit në vartësi të bashkisë Vlorë dhe për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025", miratohet plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2025 si më poshtë:

Bazuar në gërmën a) "Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil" të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", në stafin e Bashkisë Vlorë, për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2025, janë **5 punonjës** të cilët kanë mbushur moshën e pensionit (**5 pozicione**).

Bazuar në gërmën b) "Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil", të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", pozicionet vakante të planifikuara për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2025, janë **15 pozicione**.

Gjithsej vende vakante në shërbimin civil për periudhën Janar - Dhjetor 2025 në Bashkinë Vlorë janë **20 pozicione**.

**PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL TË BASHKISË VLORE PËR
VITIN 2025**

Vende të lira në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil	Kategoria	Numri i Vendeve Vakante	Klasa	Lloji i procedurës
Drejtor i Përgjithshëm	Nivel i lartë	1	I-5	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Drejtor drejtorie	Nivel i mesëm drejtues	5	II-2	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Përgjegjës sektori	Nivel i ulët drejtues	2	III-2 III-3	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Specialist	Nivel ekzekutiv	12	IV-2	Lëvizje paralele/Pranim në shërbim civil

KRYETAR

Ermal Dredha

